

NJOFTIM
Nr. 6284, datë 4.10.2019

PËR SHPALLJEN E DY VENDEVE VAKANTE PËR POZICIONIN PËRKTHYES

Në zbatim të nenit 20, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave, për personat e interesuar që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e përkthyesit, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: II-b

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- a) të zotërojnë diplomë të arsimit të lartë, preferohet në gjuhë të huaja, dega Anglisht ose Drejtësi.
- b) të kenë minimumi 2 vjet eksperiencë në përkthim shqip–anglisht–shqip.
- c) të kenë njohuri shumë të mira në terminologjinë ligjore në të dyja gjuhët.
- d) kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombëtare.

Kushte të përgjithshme:

- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t’u pajisur me certifikatë sigurie, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.

- Ndaj tyre të mos ketë nisur procedim penal, të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale.

- Ndaj tyre të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit.

- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t’u përshatur e për të punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;
2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
3. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune) (originale ose të noterizuara);
4. Dëshmi penaliteti;
5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe në trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda 10 ditëve pas publikimit të njoftimit pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në adresën: Rruga e Kavajës, ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, zyra e protokollit, nga e hëna–të premte, ora 08:30–17:00 ose, nëpërmjet postës elektronike, në adresën: info@kpk.al, i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.